



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa: Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax: ++381(0)38 229 838, e-mail: bspk@etuc.org



## Ligji i Punës

**Prishtinë, 5 Nëntor** - Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 3 Nëntor 2010, i dhanë dritën e gjelbër Ligjit të Punës. Ky Ligj ishte prioritet dhe kërkesë e kahershme e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, si përfaqësuese e punëmarrësve dhe artikuluese e kërkesave të tyre. Me organizimin e tryezave dhe konferencave, shkrime e botime të ndryshme rreth mungesës së Ligjit të Punës, propozime konkrete për amendamentimin e Projektligjit të Punës, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, BSPK-ja ka dhënë kontributin e saj që puna e përbashkët të kurorëzohet me sukses, në mënyrë që për herë të parë në Kosovën e pavarur, të punësuarit kosovar të ketë një Ligj të Punës të punuar nga vet kosovarët. Gjatë procedurës së amendamentimit të tij, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës ka propozuar 26 Amandamente, prej të cilave 19 janë aprovuar.

Me këtë rast BSPK-ë i falënderon të gjithë ata, që në forma të ndryshme kanë kontribuar në hartimin dhe miratimin e Ligjit të Punës dhe shpreson me hyrjen në fuqi të tij, përfundimisht të rregullohen të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

**Zyra për Informim, BSPK**  
**Fatma Rastelica**

**Kryetari i BSPK-së**  
**Haxhi Arifi**